



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALIQ

KRYETARI

Maliq, më 22.05.2024

PROJKET-VENDIM

Për

**“Miratim fondi për 109 (njëqind e nëntë) nxënës dhe trajnerët të Ekipeve Sportive të shkollave të Bashkisë Maliq, në kuadër të projektit “Ekipet Sportive në Shkolla”, në intenerarin Maliq-Vlorë-Maliq”**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, datë 17.12.2015 i ndryshuar, neni 8, 9 , pika 1, nënpika 1.1, gërma “b”, neni 54 “Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak” gërma “dh”, nenit 55 “Votimi , pika 2. 3 dhe 6 , neni 64 “Kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë” pika “c”, ligjit nr.9936,datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 32 “Përgatitja dhe miratimi i buxheteve vendore”, neni ligji nr.68/2018 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 54, “Rishpërndarjen e fondeve buxhetore”, ligjit nr.97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, mbështetur në vendimin nr.138 datë, 26.12.2023 të Këshilli Bashkiak Maliq “Për miratimin e buxhetit për vitin 2024”, Udhëzimit plotësuese të Ministrisë së Financave nr.1 datë, 24.01.2024 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”, ligjit nr.79/2017 “Për Sportin” i ndryshuar neni 8, pika 3, shkresës së Komitetit Olimpik Kombëtar Shqipëtar me lëndë:Festa Olimpike, I propozoj Këshillit Bashkiak

1. Të miratojë fondin prej **150.120** lekë për shpenzime udhëtimi dhe trajtimi ushqimor, për nxënës dhe trajnerët e Ekipeve Sportive të shkollave të Bashkisë Maliq, të cilët do të marrin pjesë në ceremoninë përmbyllëse të edicionit të dytë projektit “Ekipet Sportive në Shkolla”, në intenerarin Maliq-Vlorë-Maliq.
2. Paga do të kryhet nga buxheti i bashkisë Maliq për vitin 2024.
3. Bashkangjitur keni shkruar e Komitetit Olimpik Kombëtar Shqipëtar për këtë qëllim.
4. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashki.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit Nr.139/2015“Për vetë qeverisjen vendore” i ndryshuar.

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim TOPÇIU

